

VENDIM
Nr. 391, datë 21.10.2021

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KOMISIONIT KOMBËTAR RREGULLATOR
NR. 55, DATË 28.10.2019, “PËR LICENCIMIN E SHA UJËSJELLËS-KANALIZIME
ELBASAN”

Në mbështetje të neneve 13, 14, 15, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar (ligji nr. 8102), VKM-ja nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë” (VKM nr. 958), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike, që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (rregullore e licencimit),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 21.10.2021, pasi shqyrtoi çështjen me objekt: “Mbi miratimin e vendimit ‘Për licencimin e shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Elbasan’”,

VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Elbasan me shkresën nr. 2217 prot., datë 26.7.2021, me lëndë “Njoftim në lidhje me ndryshimin e drejtuesit teknik, me shkresën nr. 2895 prot., datë 22.9.2021, me lëndë “Njoftim në lidhje me ndryshimin e drejtuesit teknik dhe me shkresën nr. 4515 prot., datë 28.9.2021, me lëndë “Njoftim në lidhje me ndryshimin e drejtuesit ligjor të sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Elbasan” ka paraqitur pranë ERRU-së kërkesën për rinovim të licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor dhe teknik të shoqëruar me dokumentacionin sipas përcaktimeve të parashikuara në VKM nr. 958 dhe rregullores së licencimit.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës së UK Elbasan për rinovim licence për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor dhe teknik në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM nr. 958 dhe rregulloren e licencimit.

3. KKRR-ja ka licencuar shoqërinë UK Elbasan me vendimin nr. 55, datë 28.10.2019, “Për licencimin e sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Elbasan”, me një afat 4-vjeçar, ku shoqëria autorizohet të ofrojë shërbimin e grumbullimit dhe shpërndarjes së ujit për konsum publik, si dhe largimit të ujërave të ndotura.

4. Drejtues ligjor i shoqërisë UK Elbasan sh.a., z. Leli Kaja, ka mbaruar studimet e larta në degën ekonomik dhe juridik.

5. Drejtuesi teknik i shoqërisë UK Elbasan sh.a., znj. Lulzime Dama, ka mbaruar studimet e larta në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, në degën “Ndërtim”, profili “Inxhinier për Ndërtime Civil-Industriale Ura”, në vitin 1986.

6. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për ndryshimin e licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit teknik, ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Elbasan sh.a. të kërkesave të ligjit nr. 8102, të VKM-së nr. 958 dhe rregullores së licencimit, në mënyrë të veçantë sa i takon garantimit që i licencuari të veprojë në përputhje me kushtet e licencës së tij dhe të mbrojë interesat e konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i UK Elbasan është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Në pikën 1, të vendimit të KKRR-së nr. 55, datë 28.10.2019, “Për licencimin e sh.a. Ujësjetës-Kanalizime Elbasan”, bëhet ndryshimi si më poshtë:

“Drejtues ligjor – Leli Kaja”;

“Drejtues teknik – Lulzime Dama”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani